



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR NXJERRJEN E REZULTATIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
BASHKISË FIER, QARKU FIER, NË ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 05.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier, Qarku Fier, në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 123, neni 166, pika 1 të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Zona Zgjedhore Bashkia Fier territori i saj është i ndarë në 2 ZAZ. Në këtë rast KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatin për zonën zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Në përfundim të procesit të dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi për Kryetarin e Bashkisë Fier nga të 2 KZAZ-të e kësaj bashkie, KQZ, nxjerr rezultatin për këtë zonë zgjedhore, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit.



Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Fier, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr.57, KZAZ nr.58, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.57, KZAZ nr.58, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.
- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezulton se nuk ka mospërputhje të dhënash.

KQZ do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier, Qarku Fier, mbështetur në tabelat e rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore dhe tabelat origjinale të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, si dhe të shpall fitues kandidatin për kryetar bashkia Fier.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a" nenin 123 dhe nenin 166, pika 1, të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier, Qarku Fier, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të shpallë fitues për Kryetar të Bashkisë Fier z. Armando Nikolla Subashi, të propozuar nga Aleanca për Shqipërinë Europiane.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjyqates së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

